ASCAP

ASCAP
Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar

MODUL KURRIKULAR

Kurrikula në Bazë Shkolle në Arsimin Fillor

"SIGURIA ONLINE"

Koordinator: Eriksen Mersinllari

www.ascap.edu.al

2026

MODUL KURRIKULAR

KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE NË ARSIMIN FILLOR

TITULLI I MODULIT:

"Siguria online"

1. HYRJE

Moduli kurrikular "*Siguria online"* i hartuar në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Sigurisë Kibernetike është në përputhje me parimet dhe drejtimet themelore të Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar dhe Kurrikulës Bërthamë për Arsimin Fillor, të cilat vendosin në qendër zhvillimin e kompetencave kyçe, edukimin digjital dhe qytetar, si dhe mirëqenien e nxënësve në mjediset virtuale.

Qëllimi i modulit është të pajisë nxënësit me njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e nevojshme për të përdorur në mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme pajisjet digjitale dhe internetin, për të kuptuar rreziqet e mundshme në mjedisin online dhe për të reaguar në mënyrë të kujdesshme dhe të sigurt në situata të ndryshme, si në nivel personal ashtu edhe në ndërveprim me të tjerët.

Në këtë kuadër, moduli synon:

- zhvillimin e të kuptuarit mbi përdorimin e sigurt të internetit dhe dallimin e situatave të sigurta dhe të pasigurta;
- formimin e shkathtësive bazë për mbrojtjen e të dhënave personale dhe për reagimin e duhur në situata që i shqetësojnë;
- ndërtimin e qëndrimeve të kujdesshme dhe të përgjegjshme gjatë përdorimit të pajisjeve digjitale dhe komunikimit online.

Moduli integron dimensionin njohës me atë praktik, duke nxitur ndërgjegjësimin për sigurinë në mjedisin digjital dhe për mbrojtjen individuale gjatë përdorimit të teknologjisë. Përvetësimi i këtyre njohurive dhe zhvillimi i shkathtësive bazë kontribuojnë drejtpërdrejt në formimin e aftësive për të nxënit gjatë gjithë jetës.

Nxënësit aftësohen të dallojnë situatat e sigurta dhe të pasigurta, të marrin vendime të thjeshta dhe të përshtatin sjelljen e tyre në mënyrë të përgjegjshme. Në këtë nivel, përmbajtja trajtohet në mënyrë të thjeshtë, konkrete dhe të kuptueshme, duke u fokusuar në rregullat bazë të sigurisë online, si: mosndarja e të dhënave personale, përdorimi i kujdesshëm i pajisjeve digjitale dhe kërkimi i menjëhershëm i ndihmës nga një i rritur në rastet kur nxënësi has përmbajtje apo situata që e shqetësojnë. Siguria në mjedisin online përbën një komponent thelbësor të rolit të shkollës në mbrojtjen dhe mirëqenien e nxënësve.

Në këtë kuadër, moduli mbështet shkollat në planifikimin dhe zbatimin e veprimtarive konkrete, përmes qasjeve praktike të mësimdhënies, lojërave me role, situatave të simuluara dhe reflektimit mbi përvoja të përditshme. Në funksion të kurrikulës me bazë kompetencat, moduli kontribuon në zhvillimin e aftësive për jetën, si vetëmenaxhimi, komunikimi, bashkëpunimi dhe ndërgjegjësimi për sigurinë. Ai lidhet ngushtë edhe me edukimin për qytetari digjitale, duke ndihmuar nxënësit të ndërtojnë sjellje të sigurta dhe të përgjegjshme në përdorimin e teknologjisë.

Moduli mund të zbatohet në arsimin fillor, në kuadër të kurrikulës me bazë shkolle, duke u përshtatur sipas moshës, nevojave dhe nivelit të zhvillimit të nxënësve.

Veprimtaritë e propozuara ofrojnë mundësi të larmishme për zhvillimin e kompetencave të nxënësve në drejtim të përdorimit të sigurt të internetit dhe pajisjeve digjitale. Në këtë mënyrë, moduli kontribuon në formimin e nxënësve të vetëdijshëm, të përgjegjshëm dhe të përgatitur për të përdorur teknologjinë në mënyrë të sigurt, duke vendosur në fokus sigurinë, mirëqenien dhe zhvillimin e shëndetshëm në mjedisin digjital.

2. PËRMBAJTJA E MODULIT

Moduli është strukturuar në katër tematika kryesore që integrojnë njohuritë me aftësi praktike dhe zhvillimin e qëndrimeve të përgjegjshme në mjedisin digjital:

Në tematikën 1 "Njohja me pajisjet digjitale dhe përdorimi i tyre i sigurt", nxënësit njihen me pajisjet bazë digjitale (kompjuter, tablet, telefon) dhe përdorimin e tyre në jetën e përditshme. Përmes shembujve konkretë dhe veprimtarive të thjeshta, ata dallojnë përdorimin e drejtë dhe të gabuar të pajisjeve, si dhe kuptojnë rëndësinë e përdorimit të tyre me kujdes dhe me mbikëqyrjen e një të rrituri.

Tematika 2 "Ndjenjat dhe përjetimet në mjedisin online" përqendrohet në identifikimin e emocioneve që nxënësit përjetojnë gjatë përdorimit të internetit dhe pajisjeve digjitale. Nxënësit mësojnë të dallojnë situatat që i bëjnë të ndihen mirë ose të shqetësuar, si dhe të shprehin ndjenjat e tyre dhe të kërkojnë ndihmë në rastet kur hasin përmbajtje apo situata që i frikësojnë ose i bëjnë të pasigurt.

Në tematikën 3 "Rregullat bazë të sigurisë dhe mbrojtja e të dhënave personale", nxënësit njihen me rregullat kryesore të sigurisë në internet, si mosndarja e të dhënave personale (emër, adresë, fotografi), përdorimi i kujdesshëm i përmbajtjeve online dhe rëndësia e tregimit tek një i rritur në çdo situatë të dyshimtë. Përmes situatave të thjeshta dhe shembujve praktikë, ata zhvillojnë aftësi për të dalluar rreziqet dhe për të reaguar në mënyrë të sigurt.

Tematika 4 "Sjellja e sigurt dhe e përgjegjshme në mjedisin digjital" përqendrohet në mënyrën se si nxënësit ndërveprojnë në mjedisin online, duke theksuar rëndësinë e respektit, kujdesit për veten dhe të tjerët, si dhe ndjekjen e rregullave gjatë përdorimit të teknologjisë. Nxënësit mësojnë të marrin vendime të thjeshta dhe të përshtatshme në situata të ndryshme dhe të ndërtojnë sjellje të sigurta dhe të përgjegjshme.

Përmbajtja e modulit krijon mundësi për integrim ndërkurrikular me lëndë dhe fusha të ndryshme të të nxënit:

- *Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK*): Njohja me pajisjet digjitale dhe përdorimi i tyre në mënyrë të sigurt.
- *Qytetaria*: Zhvillimi i sjelljeve të përgjegjshme, respektit ndaj të tjerëve dhe ndërgjegjësimit për sigurinë personale dhe digjitale.
- *Gjuha shqipe*: Zhvillimi i aftësisë për të shprehur mendimet dhe ndjenjat, përshkrimi i situatave të thjeshta dhe komunikimi i qartë në situata të ndryshme.
- *Artet*: Shprehja përmes vizatimeve dhe posterave të mesazheve për sigurinë online.

3. KLASA/T KU MUND TË ZHVILLOHET MODULI

Moduli mund të zhvillohet në një nga klasat e arsimit fillor (klasat 1–2), në varësi të vendimmarrjes së shkollës dhe planifikimit në kuadër të kurrikulës me bazë shkolle.

Ai ofron fleksibilitet në përshtatjen e kohëzgjatjes dhe thellësisë së përmbajtjes, duke mundësuar që të jetë në përputhje me moshën e nxënësve, nivelin e të kuptuarit dhe zhvillimin e kompetencave të tyre. Ky fleksibilitet u mundëson shkollave të përzgjedhin klasën më të përshtatshme për zbatimin e modulit, duke marrë parasysh nevojat, interesat e nxënësve dhe kontekstin pedagogjik të institucionit.

4. MËSUESIT QË MUND TË ZHVILLOJNË MODULIN

Moduli rekomandohet të zhvillohet kryesisht nga mësuesit e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), si dhe nga mësuesit e arsimit fillor, pasi përmbajtja dhe tematika e tij lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin e kompetencës digjitale, edukimin qytetar dhe formimin e sjelljeve të sigurta dhe të përgjegjshme tek nxënësit.

Megjithatë, shkolla ka fleksibilitet në përcaktimin e mësuesve që do ta zhvillojnë modulin, në varësi të kontekstit institucional, strukturës së stafit dhe zhvillimit profesional të tij. Në këtë kuadër, moduli mund të realizohet edhe nga mësues të tjerë të formimit ndërdisiplinor, të cilët kanë kompetencat pedagogjike dhe përgatitjen e nevojshme për të udhëhequr veprimtaritë e parashikuara. Ky fleksibilitet siguron që moduli të mos kufizohet vetëm te një fushë mësimore,

por të përfitojë nga ekspertiza dhe përvoja e mësuesve në funksion të rritjes së cilësisë së procesit mësimor dhe zhvillimit të kompetencave të nxënësve.

Rekomandime për mësuesit

Gjatë zhvillimit të modulit:

- Krijoni një mjedis të sigurt dhe mbështetës, ku nxënësit të ndihen të lirshëm për të ndarë përvoja dhe shqetësime që lidhen me përdorimin e teknologjisë.
- Përdorni gjuhë të thjeshtë, konkrete dhe të kuptueshme për moshën e nxënësve.
- Shmangni përmbajtje që mund të shkaktojnë frikë ose ankth të panevojshëm.
- Fokusohuni te sjelljet e sigurta dhe zgjidhjet praktike, jo vetëm te rreziqet.
- Përdorni situata dhe shembuj nga përvoja e përditshme e nxënësve.
- Inkurajoni pyetje, diskutime dhe reflektime të hapura.
- Jepni komente vlerësuese dhe udhëzuese në mënyrë të vazhdueshme.

Menaxhimi i situatave të ndjeshme:

- Tregoni kujdes dhe ndjeshmëri ndaj nxënësve që mund të kenë përjetuar situata të pakëndshme ose shqetësuese në mjedisin online.
- Inkurajoni nxënësit të kërkojnë ndihmë nga një i rritur i besuar në çdo situatë që i shqetëson.
- Përdorni një qasje mbështetëse dhe inkurajuese, duke theksuar mesazhe pozitive për sigurinë dhe kujdesin ndaj vetes dhe të tjerëve.

Përshtatja e modulit:

- Përshtatini veprimtaritë sipas moshës dhe aftësive të nxënësve.
- Reduktoni ose zgjeroni kohëzgjatjen sipas nevojave.
- Zëvendësoni veprimtari që nuk janë të zbatueshme për kontekstin tuaj.
- Shtoni shembuj nga konteksti lokal i shkollës.
- Mund të planifikoni, sipas mundësive dhe në bashkëpunim me drejtuesit e shkollës, përfshirjen e ekspertëve (p.sh. nga fusha e sigurisë kibernetike), të cilët mund të kontribuojnë me njohuri dhe përvoja praktike.

Angazhimi i prindërve:

- Rekomandohet që mësuesi të organizojë një takim të shkurtër informues me prindërit para fillimit të modulit, duke u shpjeguar temat kryesore dhe rëndësinë e vazhdimit të bisedës në shtëpi.

- Si alternativë, mund të dërgohet një letër e shkurtër informuese me temat e modulit dhe me disa sugjerime praktike për prindërit (p.sh. si të monitorojnë kohën e ekranit, si të reagojnë kur fëmija raporton diçka shqetësuese online).
- Veprimtaria "Kalendari im javor i kohës para ekranit" (Tematika 4) realizohet me mbështetjen e drejtpërdrejtë të prindit - mësuesi informon prindërit paraprakisht për këtë detyrë.

5. KOHËZGJATJA E MODULIT

Moduli mund të integrohet në kurrikulën me bazë shkolle si një program i plotë prej **35 orësh** mësimore. Ai mund të zbatohet duke përfshirë veprimtaritë e sugjeruara për secilën tematikë, si dhe veprimtari të tjera që mësuesi i vlerëson të përshtatshme, në përputhje me nevojat dhe kontekstin e nxënësve.

Nr.	Tematika	Orët mësimore të sugjeruara[1]
1.	Njohja me pajisjet digjitale dhe përdorimi i tyre i sigurt	7 orë
2.	Ndjenjat dhe përjetimet në mjedisin online	6 orë
3.	Rregullat bazë të sigurisë dhe mbrojtja e të dhënave personale	11 orë
4.	Sjellja e sigurt dhe e përgjegjshme në mjedisin digjital	11 orë
TOTALI		**35 orë**

6. REZULTATET E TË NXËNIT

Rezultatet e të nxënit
Tematika 1: Njohja me pajisjet digjitale dhe përdorimi i tyre i sigurt
Nxënësi: • identifikon pajisjet bazë digjitale (kompjuter, tablet, telefon); • përshkruan përdorimet kryesore të pajisjeve digjitale në jetën e përditshme; • dallon përdorimin e drejtë dhe të gabuar të pajisjeve digjitale; • zbaton rregulla të thjeshta për përdorimin e sigurt të pajisjeve, nën mbikëqyrjen e një të rrituri; • demonstron sjellje të kujdesshme gjatë përdorimit të pajisjeve digjitale.

[1] *Orët e sugjeruara për tematika janë orientuese dhe mund të përshtaten nga mësuesit, të cilët kanë fleksibilitetin të riorganizojnë kohën dhe veprimtaritë sipas nevojave të nxënësve dhe kontekstit të klasës.*

Tematika 2: Ndjenjat dhe përjetimet në mjedisin online
Nxënësi: • përshkruan ndjenjat që përjeton gjatë përdorimit të internetit dhe pajisjeve digjitale (gëzim, frikë, shqetësim); • dallon situatat që ndikojnë pozitivisht ose negativisht në përjetimet e tij; • përshkruan me fjalë të thjeshta situata që e bëjnë të ndihet i pasigurt; • shpjegon rëndësinë e kërkimit të ndihmës në rastet kur përjeton shqetësim • komunikon përvojat dhe ndjenjat e tij në mënyrë të kuptueshme.
Tematika 3: Rregullat bazë të sigurisë dhe mbrojtja e të dhënave personale
Nxënësi: • përshkruan rregullat bazë të sigurisë në internet (p.sh. mbyllja e përmbajtjeve të papërshtatshme dhe informimi i një të rrituri); • zbaton rregullat e sigurisë në situata të thjeshta të përdorimit të teknologjisë; • dallon situatat e sigurta dhe të pasigurta në mjedisin digjital; • identifikon të dhënat personale (emër, moshë, shkollë, fotografi); • shpjegon pse të dhënat personale nuk duhet të ndahen me persona të panjohur; • zgjedh reagimin e duhur në situata të thjeshta kur kërkohet informacion personal
Tematika 4: Sjellja e sigurt dhe e përgjegjshme në mjedisin digjital
Nxënësi: • zbaton sjellje të përshtatshme dhe të përgjegjshme gjatë përdorimit të teknologjisë; • identifikon rëndësinë e përdorimit të balancuar të pajisjeve digjitale dhe kohës para ekranit. • demonstron bashkëpunim dhe respekt gjatë përdorimit të pajisjeve në grup; • merr pjesë në aktivitete praktike për të simuluar reagime në situata të rrezikut; • krijon produkte të thjeshta (poster, vizatim) për të paraqitur rregulla sigurie; • prezanton punën e tij dhe shpjegon rëndësinë e përdorimit të sigurt të teknologjisë.

7. Veprimtaritë praktike

Në vazhdim janë përshkruar veprimtari praktike të sugjeruara, të grupuara sipas tematikave të modulit. Mësuesi është i lirë të përzgjedhë midis veprimtarive të sugjeruara në modul, t'i përshtatë ato si dhe plotësojë me veprimtari të tjera të cilat e mbështesin për të trajtuar tematikat dhe për të përmbushur rezultatet e të nxënit.

TEMATIKA 1: NJOHJA ME PAJISJET DIGJITALE DHE PËRDORIMI I TYRE I SIGURT

Në këtë tematikë, nxënësit njihen me pajisjet bazë digjitale që përdoren në jetën e përditshme, me funksionet e tyre kryesore dhe me rregullat bazë për përdorimin e sigurt. Përmes veprimtarive konkrete, diskutimeve të drejtuara dhe situatave të thjeshta, ata zhvillojnë aftësinë për të dalluar përdorimin e drejtë dhe të gabuar të pajisjeve, si dhe kuptojnë rëndësinë e përdorimit të tyre me kujdes dhe nën mbikëqyrjen e një të rrituri.

Veprimtari: Njohim pajisjet digjitale

Qëllimi i veprimtarisë*:* Nxënësit identifikojnë pajisjet bazë digjitale, i emërtojnë ato dhe përshkruajnë përdorimet e tyre në jetën e përditshme.

Përshkrimi i veprimtarisë: Mësuesi e nis orën duke u kërkuar nxënësve të vëzhgojnë disa figura ose objekte reale, si kompjuter, tablet, telefon, tastierë, maus, ekran. Ai i pyet: "Cilën nga këto pajisje njihni?", "Ku e keni parë?", "Për çfarë përdoret?".

Nxënësit japin përgjigje nga përvoja e tyre dhe mësuesi i ndihmon të emërtojnë saktë secilën pajisje. Më pas, mësuesi zhvillon një diskutim të thjeshtë mbi përdorimin e tyre. Ai mund të drejtojë pyetje si: "A përdoret kompjuteri vetëm për lojëra?", "A mund të ndihmojë për të mësuar?", "Kur e përdorim telefonin në mënyrë të dobishme?".

Në këtë fazë, është e rëndësishme që mësuesi të theksojë se pajisjet digjitale mund të përdoren si për të mësuar, ashtu edhe për t'u argëtuar, por gjithmonë me kujdes dhe për qëllime të përshtatshme. Në vijim, nxënësit mund të ndahen në çifte ose grupe të vogla dhe secili grup të marrë një figurë të një pajisjeje. Detyra e tyre është të diskutojnë dhe të japin dy përdorime të saj. Për shembull: "**Tablet** – për të parë një video mësimore, për të vizatuar", "**Kompjuter** – për të shkruar, për të luajtur një lojë të përshtatshme" etj.

Në përmbyllje, mësuesi përmbledh idetë kryesore dhe i ndihmon nxënësit të kuptojnë se jo çdo pajisje përdoret në të njëjtën mënyrë dhe se përdorimi i saj duhet të jetë gjithmonë i përshtatshëm për moshën dhe situatën.

Pyetje orientuese për mësuesin:

- *Cilat pajisje njihni?*
- *Për çfarë përdoret secila prej tyre?*
- *Cila pajisje përdoret më shpesh në shtëpinë tuaj?*
- *A mund të përdoren këto pajisje për të mësuar?*

Përmbyllja/reflektimi: Nxënësit plotësojnë me gojë ose në fletë fjalinë:

"Sot mësova se pajisjet digjitale përdoren për _____"

Produkti i mundshëm: Vizatimi i një pajisjeje digjitale dhe shkrimi i një përdorimi të saj.

Veprimtari: Çfarë bëjmë me pajisjet digjitale?

Qëllimi i veprimtarisë: Nxënësit identifikojnë se pajisjet digjitale kanë përdorime të ndryshme dhe dallojnë përdorimet e dobishme nga ato të papërshtatshme.

Përshkrimi i veprimtarisë:

Mësuesi paraqet disa situata të thjeshta me figura, fjali ose kartela, si p.sh.:

- një fëmijë që ndjek një video mësimore;
- një fëmijë që përdor pajisjen për të vizatuar;
- një fëmijë që përdor telefonin gjatë gjithë natës;
- një fëmijë që klikon pa pyetur askënd;
- një fëmijë që përdor tabletin me prindin pranë.

Nxënësit vëzhgojnë situatat dhe me ndihmën e mësuesit, diskutojnë se cilat prej tyre janë të dobishme dhe cilat mund të jenë të papërshtatshme ose jo të sigurta. Mësuesi nuk mjaftohet vetëm me kategorizimin "mirë/keq", por kërkon nga nxënësit të japin edhe një arsye të thjeshtë. Për shembull: "*Kjo është e mirë sepse po mëson*", "*Kjo nuk është e mirë sepse është vetëm dhe nuk po e mbikëqyr askush".*

Më pas, nxënësit ndahen në grupe dhe marrin kartela me situata të ndryshme. Ata i vendosin në dy kolona: "Përdorim i dobishëm" dhe "Përdorim jo i përshtatshëm". Çdo grup prezanton zgjedhjet e tij dhe mësuesi bën sqarimet e nevojshme. Në përfundim, mësuesi thekson se përdorimi i pajisjeve nuk është gjithmonë i keq apo i mirë në vetvete, por varet nga mënyra si përdoren, për çfarë përdoren dhe nëse kemi ndihmën e një të rrituri.

Pyetje orientuese për mësuesin:

- *Çfarë po bën fëmija në këtë figurë?*
- *A është kjo një mënyrë e mirë për ta përdorur pajisjen? Pse?*
- *Kur na ndihmon teknologjia?*
- *Kur duhet të jemi më të kujdesshëm?*

Përmbyllja / reflektimi:

Nxënësit thonë:

"Një mënyrë e mirë për të përdorur pajisjet është…" ose "Duhet të kem kujdes kur…"

Produkti i mundshëm: Fletë pune me ndarjen e situatave në "të përshtatshme" dhe "jo të përshtatshme".

Veprimtari: Përdorim i sigurt apo i pasigurt?

Qëllimi i veprimtarisë: Nxënësit dallojnë situatat e sigurta dhe të pasigurta gjatë përdorimit të pajisjeve digjitale.

Përshkrimi i veprimtarisë: Mësuesi organizon një lojë të thjeshtë në klasë. Ai u tregon nxënësve një nga një figura ose u lexon situata të shkurtra. Nxënësit duhet të reagojnë duke ngritur karton jeshil për situatat e sigurta dhe karton të kuq për situatat e pasigurta.

Situatat mund të jenë si më poshtë:

- "Po përdor tabletin me mamin pranë."
- "Po klikoj një reklamë pa pyetur."
- "Po shoh një video që ma tregoi mësuesi."
- "Po përdor telefonin fshehurazi natën."
- "Po i kërkoj ndihmë babit sepse nuk kuptoj diçka në ekran."

Pas çdo përgjigjeje, mësuesi nuk kalon menjëherë te situata tjetër, por nxit një shpjegim të shkurtër: "Pse është e sigurt?", "Pse nuk është e sigurt?", "Çfarë duhet bërë ndryshe?". Kjo e ndihmon nxënësin të mos japë vetëm një reagim mekanik, por të kuptojë arsyen e zgjedhjes së tij. Më pas, nxënësit mund të punojnë në grupe dhe të krijojnë vetë 2–3 situata të sigurta ose të pasigurta, të cilat ia prezantojnë klasës. Kjo e bën orën më aktive dhe e përfshin nxënësin në krijimin e përmbajtjes.

Pyetje orientuese për mësuesin:

- *A është kjo situatë e sigurt?*
- *Kush po e ndihmon fëmijën në këtë rast?*
- *Çfarë duhet të bëjë fëmija që situata të jetë më e sigurt?*
- *A duhet të kërkojmë ndihmë?*

Përmbyllja/reflektimi: Mësuesi përmbledh duke theksuar disa rregulla bazë:

- përdor pajisjen me një të rritur;
- mos kliko pa e kuptuar;
- pyet kur nuk je i sigurt;
- zgjidh përmbajtje të përshtatshme për moshën.

Produkti i mundshëm: Kartela me situata të krijuara nga vetë nxënësit.

Veprimtari: Me leje apo pa leje?

Qëllimi i veprimtarisë: Nxënësit kuptojnë rëndësinë e përdorimit të pajisjeve vetëm me lejen dhe mbikëqyrjen e një të rrituri.

Përshkrimi i veprimtarisë: Mësuesi e nis veprimtarinë me një pyetje konkrete: "A mund t'i përdorim pajisjet kur të duam dhe si të duam?" Nxënësit japin mendimet e tyre. Pas kësaj, mësuesi paraqet situata të ndryshme, si:

- fëmija merr telefonin e prindit pa pyetur;
- fëmija i kërkon leje mësueses para se të përdorë kompjuterin;
- fëmija përdor tabletin ndërsa prindi është afër;
- fëmija luan vetëm në internet pa e ditur askush.

Nxënësit diskutojnë se cilat veprime tregojnë sjellje të përgjegjshme dhe cilat jo. Më pas, mësuesi organizon lojë me role. Një nxënës luan rolin e fëmijës, ndërsa një tjetër rolin e prindit ose mësuesit. Nxënësi duhet të kërkojë leje dhe të shpjegojë për çfarë do ta përdorë pajisjen.

Në përfundim, klasa harton një rregull të përbashkët: "Pajisjet digjitale i përdorim me lejen dhe ndihmën e një të rrituri."

Pyetje orientuese për mësuesin:

- *Pse duhet të kërkojmë leje?*
- *Pse na ndihmon një i rritur kur përdorim pajisje?*
- *Çfarë mund të ndodhë kur e përdorim pa pyetur?*

Përmbyllja/ reflektimi: Nxënësit plotësojnë fjalinë:

"Para se të përdor një pajisje, unë…"

Produkti i mundshëm:

Poster i klasës me rregullin: "Përdor me leje dhe me ndihmë".

Veprimtari: Rregullat tona për përdorimin e sigurt të pajisjeve

Qëllimi i veprimtarisë: Nxënësit përmbledhin njohuritë e fituara dhe ndërtojnë rregulla të thjeshta për përdorimin e sigurt të pajisjeve digjitale.

Përshkrimi i veprimtarisë: Mësuesi u rikujton nxënësve çfarë kanë mësuar në orët e mëparshme: cilat pajisje njohin, për çfarë përdoren, çfarë do të thotë përdorim i sigurt, pse duhet ndihma e një të rrituri. Pas këtij rikujtimi, ai u kërkon nxënësve të propozojnë rregulla që duhen ndjekur gjatë përdorimit të pajisjeve.

Nxënësit japin mendimet e tyre dhe mësuesi i shkruan në tabelë. Më pas, klasa përzgjedh 4–5 rregullat më të rëndësishme, si p.sh.:

- e përdor pajisjen me një të rritur;
- nuk klikoj pa pyetur;
- zgjedh përmbajtje të përshtatshme;
- tregoj kur shoh diçka që nuk më pëlqen;

- e përdor pajisjen me kujdes.

Pas kësaj, nxënësit punojnë në grupe dhe krijojnë një poster, një vizatim ose një fletë të ilustruar me këto rregulla. Secili grup prezanton punën e tij dhe mësuesi i ndihmon të formulojnë qartë mesazhin.

Në fund, punimet mund të vendosen në klasë si kujtesë e përhershme.

Pyetje orientuese për mësuesin:

- *Cilat rregulla janë më të rëndësishme për ju?*
- *Cili rregull ju ndihmon më shumë të jeni të sigurt?*
- *Pse duhet t'i kujtojmë këto rregulla?*

Përmbyllja/reflektimi:

Nxënësit plotësojnë: "Një rregull që do të ndjek gjithmonë është…"

Produkti i mundshëm: Poster ose rregullore e klasës për përdorimin e sigurt të pajisjeve digjitale.

Veprimtari: Trego dhe shpjego

Qëllimi i veprimtarisë: Nxënësit zhvillojnë aftësinë për të folur me një fjalor të përshtatshëm rreth pajisjeve digjitale dhe rregullave të përdorimit të tyre të sigurt.

Përshkrimi i veprimtarisë: Mësuesi u kërkon nxënësve të zgjedhin një figurë të një pajisjeje digjitale ose një vizatim të bërë prej tyre. Çdo nxënës del para klasës dhe thotë me fjali të shkurtra:

- emrin e pajisjes;
- për çfarë përdoret;
- një rregull sigurie që duhet ndjekur gjatë përdorimit të saj.

Për nxënësit që e kanë më të vështirë të flasin, mësuesi mund të përdorë pyetje ndihmëse: "Si quhet?", "Për çfarë e përdorim?", "Çfarë duhet të bëjmë që ta përdorim në mënyrë të sigurt?". Kjo veprimtari ndihmon jo vetëm në përforcimin e përmbajtjes së tematikës, por edhe në zhvillimin e komunikimit dhe të vetëbesimit të nxënësve.

Përmbyllja / reflektimi: Mësuesi thekson se njohja e pajisjeve dhe e rregullave të përdorimit të tyre është hapi i parë për të qenë të sigurt në mjedisin digjital.

TEMATIKA 2: NDJENJAT DHE PËRJETIMET NË MJEDISIN ONLINE

Në këtë tematikë, nxënësit mësojnë të dallojnë dhe të shprehin ndjenjat që përjetojnë gjatë përdorimit të internetit dhe pajisjeve digjitale. Përmes situatave të thjeshta, veprimtarive praktike, lojërave dhe diskutimeve të drejtuara, ata aftësohen të kuptojnë kur një përvojë online

është e këndshme, kur është shqetësuese dhe si duhet të reagojnë në mënyrë të sigurt. Kjo tematikë ndihmon në zhvillimin e sigurisë emocionale, vetëbesimit dhe gatishmërisë për të kërkuar ndihmë nga një i rritur.

Veprimtari: Fytyrat e emocioneve

***Qëllimi i veprimtarisë*:** Nxënësit identifikojnë dhe përshkruajnë ndjenjat që mund të përjetojnë gjatë përdorimit të internetit dhe pajisjeve digjitale.

Përshkrimi i veprimtarisë: Mësuesi paraqet figura me fytyra që shprehin emocione të ndryshme, si: gëzim, frikë, shqetësim, habi, qetësi. Ai i pyet nxënësit se çfarë emocioni tregon secila fytyrë dhe në cilat raste mund të ndihet kështu një fëmijë kur përdor internetin ose një pajisje digjitale.

Më pas, mësuesi paraqet situata të thjeshta, si p.sh.:

- po shoh një video me këngë dhe figura të bukura;
- në ekran del diçka që nuk e kuptoj;
- një figurë ose zë më tremb;
- po luaj një lojë të bukur me mamin pranë.

Nxënësit lidhin secilën situatë me emocionin përkatës. Mësuesi i nxit të shprehen me fjali të thjeshta: "Në këtë rast do të ndihesha…".

Në përfundim, nxënësit zgjedhin një emocion dhe e vizatojnë në fletë, duke e shoqëruar me një situatë të thjeshtë.

***Përmbyllje reflektuese*:** Nxënësit plotësojnë fjalinë: "Kur përdor internetin, unë mund të ndihem…"

Veprimtari: Hapat që më mbajnë të sigurt

Qëllimi i veprimtarisë: Nxënësit rendisin dhe zbatojnë hapat kryesorë që duhen ndjekur kur përjetojnë një situatë shqetësuese online.

Përshkrimi i veprimtarisë: Mësuesi nis me pyetjen: "Çfarë duhet të bëjmë kur shohim diçka që na tremb ose nuk na pëlqen?". Nxënësit japin mendime, pastaj mësuesi paraqet hapat kryesorë:

- ndalem;
- nuk klikoj më tej;
- i tregoj një të rrituri;
- shpjegoj si ndihem.

Më pas, nxënësit ndahen në grupe dhe marrin kartela me këta hapa të përzier. Detyra e tyre është t'i vendosin në rendin e duhur. Çdo grup shpjegon renditjen e vet dhe mësuesi përforcon logjikën e veprimit. Në fund, klasa e përsërit së bashku këtë renditje si një rregull të thjeshtë sigurie.

Përmbyllje reflektuese: Nxënësit plotësojnë: "Kur diçka më shqetëson, unë fillimisht…"

Veprimtari: Njeri apo makinë? Le ta zbulojmë!"

Qëllimi i veprimtarisë:

Nxënësit dallojnë ndërmjet njerëzve dhe pajisjeve digjitale, duke kuptuar se këto të fundit janë mjete dhe nuk kanë ndjenja si njerëzit.

Përshkrimi i veprimtarisë:

Veprimtaria nis me një bisedë të thjeshtë dhe miqësore. Mësuesi pyet nxënësit: "Kur përdorni telefonin, tabletin apo një lojë, me kë mendoni se po flisni?" Nxënësit ndajnë mendimet e tyre dhe mësuesi i dëgjon, duke i ndihmuar të shprehen lirshëm. Më pas, mësuesi u tregon disa figura të thjeshta dhe të njohura për ta: një fëmijë, një mësues, një robot, një pajisje që "flet", apo një personazh loje. Nxënësit, së bashku me mësuesin, i vendosin këto figura në dy grupe: **"njerëz të vërtetë"** dhe **"makina / programe"**.

Gjatë kësaj veprimtarie, mësuesi i udhëheq nxënësit drejt një ideje të rëndësishme, duke e shpjeguar në mënyrë të thjeshtë:Njerëzit mendojnë dhe ndjejnë, ndërsa pajisjet dhe personazhet digjitale nuk kanë ndjenja dhe nuk janë njerëz, ato janë mjete që na ndihmojnë.

Në vijim, mësuesi paraqet disa situata të vogla, si p.sh.:

"Një lojë të thotë: më trego emrin tënd" ose

"Një zë në telefon të bën një pyetje".

Nxënësit diskutojnë së bashku: kujt mund t'i tregojmë informacion dhe kujt jo.

Në përfundim, mësuesi përmbledh mesazhin kryesor me një gjuhë të thjeshtë dhe të qartë: *Pajisjet digjitale janë makina që na ndihmojnë, por nuk janë miq si njerëzit, prandaj duhet të kemi kujdes çfarë u tregojmë.*

Si reflektim, nxënësit plotësojnë me gojë ose me ndihmën e mësuesit fjalinë:

"Kur përdor një pajisje digjitale, unë kujtoj se ajo është _____."

Produkti i mundshëm:

- Poster i thjeshtë me dy kategori: "njeri" dhe "makinë";
- Fjali reflektuese nga nxënësit.

Veprimtari: I tregoj një të rrituri

Qëllimi i veprimtarisë: Nxënësit praktikojnë mënyrën si të kërkojnë ndihmë nga një i rritur kur ndihen të shqetësuar në mjedisin online.

Përshkrimi i veprimtarisë: Mësuesi paraqet një situatë të thjeshtë, p.sh.: "Po shihje një video dhe papritur doli diçka që të trembi." Pastaj organizon lojë me role në çifte. Njëri nxënës luan rolin e fëmijës, tjetri rolin e një të rrituri (prind, mësues, kujdestar).

Nxënësi që luan rolin e fëmijës duhet të tregojë:

- çfarë ndodhi;
- si u ndje;
- çfarë ndihme kërkon.

Mësuesi mund të ofrojë modele fjalish:

- "Pashë diçka që nuk më pëlqeu."
- "U ndjeva i frikësuar."
- "Mund të më ndihmosh?"

Disa çifte prezantojnë para klasës. Më pas, mësuesi diskuton me nxënësit: "Pse është e rëndësishme të flasim menjëherë?", "Kujt mund t'i drejtohemi?".

Përmbyllje reflektuese: Nxënësit thonë: "Kur kam nevojë për ndihmë, unë mund t'i tregoj…"

Veprimtari: Posteri "Flas kur diçka më shqetëson"

***Qëllimi i veprimtarisë*:** Nxënësit përmbledhin njohuritë e fituara dhe i shprehin ato përmes një produkti të thjeshtë vizual.

***Përshkrimi i veprimtarisë*:** Mësuesi rikujton me klasën çfarë kanë mësuar: cilat ndjenja mund të përjetojnë, cilat situata mund t'i shqetësojnë dhe çfarë duhet të bëjnë në raste të tilla. Më pas, nxënësit ndahen në grupe dhe krijojnë një poster me mesazhe të shkurtra, si:

- "Flas kur diçka më tremb."
- "I tregoj mësuesit."
- "I tregoj prindit."
- "Nuk e mbaj për vete."

Ata përdorin vizatime, ngjyra dhe fjali të thjeshta. Në fund, grupet prezantojnë posterat dhe shpjegojnë mesazhin kryesor.

Përmbyllje reflektuese: Nxënësit plotësojnë: "Kur ndihem i shqetësuar, më ndihmon që…"

Produkti i mundshëm: Poster i klasës me mesazhin: "Flas kur diçka më shqetëson."

TEMATIKA 3: RREGULLAT BAZË TË SIGURISË DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Në këtë tematikë, nxënësit njihen me rregullat bazë të sigurisë në kompjuter dhe me rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale. Përmes situatave të thjeshta, lojërave didaktike, klasifikimit të informacionit, ata mësojnë të dallojnë se cilat të dhëna duhen mbajtur private, kur një situatë mund të jetë e pasigurt dhe si duhet të reagojnë në mënyrë të kujdesshme dhe të sigurt.

Veprimtari: Cilat janë të dhënat personale?

Qëllimi i veprimtarisë: Nxënësit identifikojnë të dhënat personale dhe kuptojnë se ato duhen mbrojtur.

Përshkrimi i veprimtarisë: *Bisedë hyrëse:* Mësuesi nis veprimtarinë me pyetjen: "Cilat gjëra flasin për ne dhe tregojnë kush jemi?". Nxënësit japin mendime të lira.

Shpjegim i thjeshtë: Mësuesi prezanton disa shembuj informacioni, si:

- emri
- mosha
- shkolla
- adresa
- fotografia

Ai shpjegon me gjuhë të thjeshtë se këto quhen të dhëna personale dhe se nuk duhet t'ua japim personave të panjohur.

Punë në grupe: Çdo grup merr kartela me fjalë ose figura dhe duhet t'i ndajë në dy kategori:

- Të dhëna personale
- Jo të dhëna personale

Prezantimi: Grupet shpjegojnë zgjedhjet e tyre dhe mësuesi bën sqarimet e nevojshme.

Përmbledhje: Mësuesi thekson se të dhënat personale duhen mbrojtur, sepse lidhen drejtpërdrejt me identitetin e fëmijës.

Përmbyllje reflektuese: Nxënësit plotësojnë: "Një e dhënë personale është…"

Veprimtari: Çfarë futet në kutinë e sekreteve?

Qëllimi i veprimtarisë: Nxënësit dallojnë informacionin personal që duhet ruajtur dhe kuptojnë se jo çdo e dhënë mund të ndahet me të tjerët.

Përshkrimi i veprimtarisë: Bisedë hyrëse: Mësuesi vendos në klasë një kuti ose zarf të dekoruar me titullin "Kutia e sekreteve" dhe pyet nxënësit: "Çfarë gjërash duhet t'i mbajmë vetëm për vete ose t'ia tregojmë vetëm një të rrituri të besuar?". Nxënësit japin mendime të lira dhe mësuesi i orienton gradualisht drejt idesë së të dhënave personale.

Mësuesi shpërndan fletushka me fjalë ose figura, si p.sh.:

- emri
- adresa
- fotografia
- shkolla
- lodra e preferuar
- ngjyra e preferuar
- mosha
- fjalëkalimi

Nxënësit, në grupe të vogla, diskutojnë dhe vendosin cilat fletushka duhet të futen në "Kutinë e sekreteve" dhe cilat jo. Ata duhet të shpjegojnë shkurt pse e morën atë vendim.

Lojë didaktike: Një përfaqësues nga secili grup vjen pranë kutisë dhe vendos fletushkat që grupi mendon se duhen ruajtur. Fletushkat e tjera vendosen jashtë kutisë. Më pas, klasa diskuton së bashku zgjedhjet.

Diskutim i drejtuar: Mësuesi bën pyetje si:

- "Pse mendoni se kjo fletushkë duhet ruajtur?"
- "A mund t'ia themi këtë informacion kujtdo?"
- "Kujt mund t'ia tregojmë me siguri?"

Mësuesi thekson se disa të dhëna janë personale dhe duhen mbrojtur. Ato nuk ndahen me persona të panjohur dhe nuk publikohen pa lejen e një të rrituri.

Përmbyllje reflektuese: Nxënësit plotësojnë fjalinë: "Një informacion që duhet ta ruaj është…"

Produkti i mundshëm: "Kutia e sekreteve" me fletushka të përzgjedhura nga nxënësit.

Veprimtari: Çfarë duhet të bëj në këtë rast?

Qëllimi i veprimtarisë: Nxënësit zgjedhin reagimin e duhur në situata të thjeshta ku kërkohet informacion personal.

Përshkrimi i veprimtarisë: Mësuesi pyet: "Çfarë mund të bëjmë nëse dikush na kërkon emrin, shkollën apo fotografinë?"

Paraqitja e situatave: Mësuesi lexon ose shfaq situata të thjeshta, si:

- "Një dritare dialoguese kërkon emrin tënd."
- "Dikush kërkon fotografinë tënde."
- "Një lojë pyet në cilën shkollë mëson."
- "Një mesazh kërkon të dhëna për ty."

Punë në grupe: Çdo grup diskuton dhe zgjedh reagimin e duhur. Mësuesi i ndihmon të përdorin përgjigje të thjeshta si:

- nuk e jap;
- ndalem;
- i tregoj një të rrituri.

Prezantim: Grupet prezantojnë zgjidhjet e tyre dhe shpjegojnë pse i zgjodhën ato.

Përmbledhje: Mësuesi përforcon rregullin: *nuk ndaj të dhëna personale dhe i tregoj një të rrituri.*

***Përmbyllje reflektuese*:** Nxënësit thonë: "Në këtë rast, unë do të…"

Veprimtari: Gjej rregullin e sigurisë

Qëllimi i veprimtarisë: Nxënësit njohin dhe zbatojnë rregullat bazë të sigurisë në internet.

Përshkrimi i veprimtarisë: Mësuesi paraqet disa rregulla të thjeshta të sigurisë online, si:

- nuk jap të dhëna personale;
- nuk klikoj pa pyetur;
- ndalem kur diçka më duket e çuditshme;
- i tregoj një të rrituri.

Më pas ai paraqet situata të ndryshme dhe u kërkon nxënësve të lidhin secilën situatë me rregullin përkatës.

Shembuj:

- "Më doli një pyetje që kërkon emrin tim" → nuk jap të dhëna personale
- "Nuk e kuptoj çfarë u hap në ekran" → ndalem dhe i tregoj një të rrituri
- "Më shfaqet një buton që nuk e njoh" → nuk klikoj pa pyetur

Punë në çift: Nxënësit bashkojnë kartelën e situatës me kartelën e rregullit.

Diskutim: Mësuesi pyet: "Pse ky rregull është i duhuri?", "Çfarë mund të ndodhë nëse nuk e ndjekim?"

Përmbledhje: Mësuesi thekson se rregullat e sigurisë na ndihmojnë të mbrohemi në internet.

Përmbyllje reflektuese: Nxënësit plotësojnë: "Një rregull i rëndësishëm i sigurisë është…"

Veprimtari: Plotësojmë kartën time të sigurisë

***Qëllimi i veprimtarisë*:** Nxënësit përmbledhin rregullat bazë të sigurisë dhe i organizojnë ato në një produkt personal të thjeshtë.

***Përshkrimi i veprimtarisë*:** Mësuesi shpërndan një model të thjeshtë "karte sigurie", ku nxënësit plotësojnë ose vizatojnë:

- një e dhënë personale që duhet mbrojtur;
- një rregull që duhet ndjekur;
- një person të rritur të cilit mund t'i drejtohen për ndihmë.

Për nxënësit më të vegjël, kjo mund të bëhet me figura dhe me ndihmën e mësuesit. Për shembull:

- vizato emrin tënd me një dryn

- vizato mësuesen ose prindin
- vizato një shenjë "stop" për të treguar që nuk duhet ndarë informacioni

Prezantimi: Disa nxënës prezantojnë kartën e tyre para klasës.

Përmbledhje: Mësuesi thekson se secili mund të ketë "rregullat e veta të sigurisë", por ato mbështeten gjithmonë te kujdesi, ndalimi dhe kërkimi i ndihmës.

*Përmbyllje reflektuese***:** Nxënësit plotësojnë: "Për të qenë i sigurt, unë…"

Produkti i mundshëm: Kartë personale sigurie.

Veprimtari: Krijojmë posterin "Ruaj të dhënat e mia"

Qëllimi i veprimtarisë: Nxënësit përforcojnë njohuritë mbi të dhënat personale dhe rregullat bazë të sigurisë përmes një produkti të përbashkët.

Përshkrimi i veprimtarisë: Rikujtim: Mësuesi përmbledh me klasën çfarë kanë mësuar:

- Çfarë janë të dhënat personale
- Pse nuk duhen ndarë
- Çfarë duhet të bëjnë kur dikush i kërkon

Punë në grupe: Nxënësit krijojnë një poster me mesazhe të shkurtra, si:

- "Ruaj të dhënat e mia"
- "Nuk jap emrin dhe adresën"
- "Nuk ndaj fotografinë"
- "I tregoj një të rrituri"

Ata përdorin vizatime, simbole, ngjyra dhe fjali të shkurtra.

Prezantimi: Çdo grup prezanton posterin dhe shpjegon mesazhin kryesor.

Përmbledhje: Mësuesi thekson se mbrojtja e të dhënave personale është një nga rregullat më të rëndësishme të sigurisë online.

*Përmbyllje reflektuese***:** Nxënësit thonë: "Një e dhënë që duhet ta ruaj është…"

Produkti i mundshëm: Poster i klasës me mesazhin: **"Ruaj të dhënat e mia."**

TEMATIKA 4: SJELLJA E SIGURT DHE E PËRGJEGJSHME NË MJEDISIN DIGJITAL

Në këtë tematikë, nxënësit mësojnë të ndërtojnë sjellje të sigurta, të kujdesshme dhe etike gjatë përdorimit të teknologjisë. Përmes situatave të thjeshta, veprimtarive praktike dhe diskutimeve të drejtuara, ata kuptojnë rëndësinë e respektit ndaj të tjerëve, përdorimit të drejtë të materialeve digjitale, ndjekjes së rregullave dhe menaxhimit të kohës para ekranit. Kjo tematikë synon të

ndihmojë nxënësit të zhvillojnë sjellje të përgjegjshme dhe zakone të shëndetshme në përdorimin e pajisjeve digjitale.

Veprimtari: Si komunikojmë me respekt në mjedisin digjital?

Qëllimi i veprimtarisë: Nxënësit kuptojnë rëndësinë e përdorimit të një gjuhe të sjellshme dhe të respektueshme gjatë komunikimit në mjedisin digjital.

Përshkrimi i veprimtarisë: Bisedë hyrëse: Mësuesi nis veprimtarinë me pyetje të thjeshta, si: "A duhet të përdorim fjalë të mira edhe kur komunikojmë përmes teknologjisë?", "Si ndihet një shok nëse i shkruajmë ose i themi diçka jo të sjellshme?". Nxënësit japin mendime nga përvoja e tyre.

Paraqitja e situatave: Mësuesi paraqet disa situata të thjeshta që lidhen me komunikimin në mjedisin digjital, p.sh.:

- dërgoj një mesazh të sjellshëm;
- përdor fjalë fyese ose tallëse;
- falënderoj një shok për ndihmën;
- qesh me gabimin e tjetrit në një aktivitet digjital;
- shkruaj me qetësi dhe respekt.

Punë në grupe: Çdo grup merr një situatë dhe diskuton: A është kjo mënyrë e duhur komunikimi? Si ndihet tjetri? Si mund të thuhet ose të shkruhet më mirë?

Prezantim: Grupet prezantojnë situatën e tyre dhe japin një shembull të sjelljes së duhur.

Diskutim i drejtuar: Mësuesi nxit reflektimin me pyetje si: "*Pse është e rëndësishme të jemi të sjellshëm edhe online?" "A mund ta lëndojmë dikë me fjalë, edhe kur nuk jemi pranë tij?" "Çfarë fjalësh tregojnë respekt?"*

Përmbledhje: Mësuesi thekson se edhe në mjedisin digjital duhet të komunikojmë me edukatë, respekt dhe duhet të tregojmë kujdes për ndjenjat e të tjerëve.

Përmbyllje reflektuese: Nxënësit plotësojnë fjalinë: "Kur komunikoj në mjedisin digjital, unë…"

Veprimtari: A është puna ime apo e dikujt tjetër?

Qëllimi i veprimtarisë: Nxënësit kuptojnë se materialet e krijuara nga të tjerët duhen respektuar dhe nuk duhen paraqitur si të vetat.

Përshkrimi i veprimtarisë: Bisedë hyrëse: Mësuesi nis me një pyetje të thjeshtë: "Nëse shoku yt bën një vizatim të bukur, a mund ta marrësh dhe të thuash që e ke bërë ti?". Nxënësit përgjigjen dhe diskutojnë. Mësuesi shpjegon në mënyrë të thjeshtë se edhe në kompjuter ose

internet ka punë të krijuara nga të tjerët, si: vizatime, fotografi, tregime, video. Edhe këto duhen respektuar.

Punë në grupe: Mësuesi jep situata të thjeshta, p.sh.:

- një nxënës përdor vizatimin e shokut dhe thotë se është i tij;
- një nxënës merr një vizatim nga interneti pa treguar që nuk e ka bërë vetë;
- një nxënës kërkon leje ose thotë: "Këtë e ka bërë shoku im."

Nxënësit diskutojnë se cilat sjellje janë të drejta dhe cilat jo.

Përmbledhje: Mësuesi thekson se duhet të themi të vërtetën për punën tonë dhe të respektojmë materialet e të tjerëve.

Përmbyllje reflektuese: Nxënësit plotësojnë: "Kur përdor një punë të bërë nga dikush tjetër, unë…"

Veprimtari: Sa kohë kaloj para ekranit?

Qëllimi i veprimtarisë: Nxënësit ndërgjegjësohen për rëndësinë e përdorimit të balancuar të pajisjeve digjitale dhe kohës para ekranit.

Përshkrimi i veprimtarisë: Bisedë hyrëse: Mësuesi pyet: "Çfarë bëni zakonisht me telefonin, tabletin ose televizorin?", "A është mirë të rrimë shumë gjatë para ekranit?". Nxënësit ndajnë përvoja të thjeshta.

Diskutim i drejtuar: Mësuesi shpjegon me gjuhë të përshtatshme se përdorimi i pajisjeve është i dobishëm, por duhet të ketë kufi dhe balancë me aktivitete të tjera: lojë, pushim, lëvizje, lexim, kohë me familjen.

Veprimtari praktike: Nxënësit marrin figura të veprimtarive të ndryshme (përdorim tableti, lexim, lojë në mjedis të hapur, gjumë, vizatim, kohë me familjen) dhe i rendisin aktivitet për të pasur një ditë të balancuar. Grupet tregojnë renditjen e tyre dhe shpjegojnë pse është e rëndësishme të kemi kohë edhe për veprimtari të tjera.

Përmbledhje: Mësuesi thekson se përdorimi i pajisjeve duhet të jetë i kufizuar, i dobishëm dhe i balancuar.

Përmbyllje reflektuese: Nxënësit plotësojnë: "Përveç ekranit, mua më pëlqen edhe të…"

Veprimtari: Kalendari im javor i kohës para ekranit

Qëllimi i veprimtarisë: Nxënësit vëzhgojnë dhe paraqesin në mënyrë të thjeshtë kohën që kalojnë para pajisjeve digjitale gjatë një jave, duke reflektuar mbi rëndësinë e përdorimit të balancuar të tyre.

Përshkrimi i veprimtarisë: Bisedë hyrëse: Mësuesi nis veprimtarinë me pyetje si: “A e dimë sa kohë kalojmë para telefonit, tabletit, televizorit ose kompjuterit?”, “A përdorim pajisjet digjitale çdo ditë njësoj?”. Nxënësit japin mendimet e tyre dhe ndajnë përvoja të thjeshta.

Shpjegimi i detyrës: Mësuesi u paraqet nxënësve një model të thjeshtë kalendari javor me ditët e javës. Për secilën ditë, nxënësit do të shënojnë, me ndihmën e prindit, sa kohë kanë kaluar para pajisjeve digjitale.

Diskutim dhe krahasim: Pasi e plotësojnë, nxënësit vëzhgojnë kalendarin e tyre dhe diskutojnë:

- Në cilat ditë kam kaluar më shumë kohë para ekranit?
- Në cilat ditë kam kaluar më pak?
- A kam pasur kohë edhe për lojë, pushim, lexim dhe familjen?

Prezantim: Disa nxënës prezantojnë kalendarin e tyre dhe ndajnë një vëzhgim të thjeshtë, si p.sh.: “Të shtunën kam parë më shumë televizor”, “Të hënën kam luajtur më pak në tablet”.

Përmbledhje: Mësuesi thekson se vëzhgimi i kohës para ekranit i ndihmon nxënësit të kuptojnë më mirë zakonet e tyre dhe të ndërtojnë një përdorim më të balancuar të pajisjeve digjitale.

Veprimtari: Zgjedhja më e mirë

Qëllimi i veprimtarisë: Nxënësit marrin vendime të thjeshta dhe të përgjegjshme në situata që lidhen me sjelljen etike dhe përdorimin e teknologjisë.

Përshkrimi i veprimtarisë: Mësuesi paraqet situata të shkurtra, si:

- shoku yt harroi të mbyllë pajisjen;
- një shok merr punën e tjetrit dhe thotë se është e tij;
- dikush do të përdorë tabletin më gjatë se koha e caktuar;
- një nxënës nuk pret radhën dhe ndërhyn te puna e grupit.

Nxënësit diskutojnë në çifte ose grupe të vogla dhe zgjedhin zgjidhjen më të mirë. Ata duhet të shpjegojnë: çfarë nuk shkon në situatë; çfarë duhet bërë; pse ajo zgjedhje është më e përshtatshme.

Përmbledhje: Mësuesi thekson se të jesh përdorues i përgjegjshëm do të thotë të zgjedhësh sjelljen e duhur edhe në situata të vogla të përditshme.

Veprimtari: Rregullat tona për përdorim të përgjegjshëm të teknologjisë

Qëllimi i veprimtarisë: Nxënësit ndërgjegjësohen dhe formulojnë rregulla të thjeshta për përdorimin e sigurt, etik dhe të përgjegjshëm të teknologjisë.

Përshkrimi i veprimtarisë: Veprimtaria nis me një rikujtim të shkurtër nga ana e mësuesit, i cili rikthen idetë kryesore të trajtuara më parë: rëndësinë e respektimit të të tjerëve gjatë përdorimit të teknologjisë, kujdesin ndaj pajisjeve, respektimin e punës së të tjerëve dhe

menaxhimin e kohës para ekranit. Përmes pyetjeve të thjeshta, nxënësit ftohen të reflektojnë pse këto rregulla janë të rëndësishme në jetën e përditshme.

Më pas, nxënësit ndahen në grupe të vogla dhe punojnë së bashku për të përzgjedhur disa nga rregullat më të rëndësishme. Ata i paraqesin këto rregulla në mënyrë krijuese, përmes posterëve, vizatimeve apo fjalive të shkurtra, duke i bërë ato të kuptueshme dhe tërheqëse.

Në vijim, secili grup prezanton punën e tij para klasës. Nën drejtimin e mësuesit, zhvillohet një diskutim i shkurtër ku përzgjidhen dhe përmblidhen rregullat më të rëndësishme. Këto rregulla bashkohen në një listë të përbashkët, duke krijuar kështu një "rregullore klase" për përdorimin e përgjegjshëm të teknologjisë.

Në përfundim, mësuesi thekson se përdorimi i teknologjisë nuk lidhet vetëm me shmangien e rreziqeve, por edhe me sjelljen e drejtë, respektin ndaj të tjerëve dhe përgjegjësinë personale.

Si reflektim, nxënësit plotësojnë fjalinë: "Një rregull që do të zbatoj është…", duke e lidhur të nxënin me përvojën e tyre personale.

Produkti i mundshëm: Poster ose rregullore klase për përdorim të përgjegjshëm të teknologjisë, e cila mund të vendoset në klasë si kujtesë e përditshme për nxënësit.

8. Produkti final i modulit

Në përfundim të modulit, nxënësit realizojnë një produkt përfundimtar, individual ose në grup, i cili demonstron në mënyrë të integruar njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e zhvilluara gjatë gjithë procesit mësimor.

Produkti synon të lidhë të nxënit me situata të përditshme dhe të nxisë ndërgjegjësimin e nxënësve për përdorimin e sigurt, të përgjegjshëm dhe etik të internetit dhe pajisjeve digjitale.

Produkti mund të marrë forma të ndryshme, si p.sh.:

1. ***Hartimi i një posteri ose rregulloreje për përdorimin e sigurt të internetit dhe pajisjeve digjitale,*** ku përfshihen rregulla të thjeshta për mbrojtjen e të dhënave personale, sjelljen e përgjegjshme në mjedisin digjital, kërkimin e ndihmës nga një i rritur dhe përdorimin e balancuar të kohës para ekranit.
2. ***Zhvillimi i një fushate ndërgjegjësuese në klasë ose në shkollë***, përmes posterave, vizatimeve, mesazheve të thjeshta, sloganeve ose prezantimeve të shkurtra, me tema si: "Ruaj të dhënat e mia", "Flas kur diçka më shqetëson", "Përdor teknologjinë me përgjegjësi", "Respektoj veten dhe të tjerët online".
3. ***Krijimi i një libri të vogël me rregulla dhe këshilla për sigurinë online****,* ku nxënësit, individualisht ose në grup, përmbledhin në mënyrë të thjeshtë dhe të ilustruar mesazhet kryesore të modulit, si: mbrojtja e të dhënave personale, reagimi në situata shqetësuese,

përdorimi i kujdesshëm i pajisjeve digjitale, komunikimi me respekt dhe përdorimi i balancuar i kohës para ekranit.

Shënim: Moduli që zhvillohet në kuadër të kurrikulës me bazë shkolle vlerësohet vetëm mbi bazën e kryerjes së modulit (moduli nuk vlerësohet me notë).

9. Burime mbështetëse:

- *Teach Computing / Primary online safety resources — https://teachcomputing.org/primary-online-safety-resources*
- *UK Safer Internet Centre / Teaching resources — https://saferinternet.org.uk/guide-and-resource/teachers-and-school-staff/teaching-resources*
- *UK Safer Internet Centre / Safer Internet Day education resources — https://saferinternet.org.uk/safer-internet-day/safer-internet-day-2026/education-resources*
- *Google / Be Internet Awesome — https://beinternetawesome.withgoogle.com/en_us*